



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Nr. 10293/prot.
1

Durrës, më 18/8 /2020

VENDIM

Nr. 591, datë 18.08, 2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR
PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, BASHKIA
DURRËS

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligjit Nr. 97/2019 „Për miratimin e Aktit Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave „Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore“, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 887 datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", VKM Nr.686 Dt.22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar, pas dorëzimit të Dokumentit të Planit të Detyruar Vendor pikësor nga AKPT -të, hartuar nga studio "B L" shpk, si dhe pas bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe raportin e vlerësimit teknik të përgatitur nga strukturat përgjegjëse për këtë dokument.

VENDOSA

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore për 4 banesat kolektive Bashkia Durrës, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentat e mëposhtëm:
 - a. Raporti i Planit të Detyruar Vendor për zonat e dëmtuara pikësore;
 - b. Materiali hartografik
2. Miratohet rindërtimi në Zonat e dëmtuara pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore, me qëllim rindërtimin e objekteve

të cilat referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për zonën e dëmtuar pikësore, për 4 banesat kolektive Durrës, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i detyruar Vendor për zonën e dëmtuar pikësore, për 4 banesat kolektive të integrohet me Planin e Përgjithshëm Vendor në fuqi.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e Planit të Detyruar Vendor për zonën e dëmtuar pikësore, si dhe bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të tij në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

